

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës



Skenar për orë mësimi Si të parandalojmë trafikimin me fëmijë të moshës së hershme shkollore (klasa I)

Autor: Dr. Verica Stamenkova Trajkova
Shkup, prill 2026

Titulli origjinal në gjuhën maqedonase: Сценарио за на час: превенција на трговијата со деца од рана училишна возраст (I одделение)

Ky material edukativ u prodhuan me mbështetjen e financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon “©Këshilli i Evropës, viti i botimit”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Departamentit të Publikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Përgjithshme për Demokraci dhe Dinjitet Njerëzor, Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France, Tel. +33 (0)3 88 41 20 00
E-mail: Horizontal.Facility@coe.int

Fotografia kryesore: Shutterstock
Ilustrime: Sara Prenc

© Këshilli i Evropës, prill 2026. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I licencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara

Skenar për orë mësimi: Si të parandalojmë trafikimin me fëmijë të moshës së hershme shkollore (klasa I)

Shtjellimi i tregimit “*Pinoku*” të Karlo Kolodit – mësim për besimin, rrezikun dhe mbrojtjen nga keqpërdorimi dhe trafikimi me njerëz

Lënda mësimore	Shoqëri
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	Klasa I
Tema/fusha në programin shkollor	• Mbrojtja e të drejtave të fëmijës • Mbrojtja e të drejtave të njeriut
Numri i orëve	Gjithsej një orë shkollore
Pajisje dhe mjete	• Tregimi “<i>Pinoku</i>” • Mjete ndihmëse audio-vizuale, të përshtatura sipas moshës • Fletë vizatimi (sipas dëshirës) • Markera (stilolapsa me shtupë), lapsa me ngjyrë ose ngjyra dylli • Gërshërë (sipas dëshirës, për prerjen e vizatimeve) • Plastelinë për modelim të personazheve • Shënime për mësuesin
Qëllimet	Qëllimi i përgjithshëm Të nxitet njohja, ndjeshmëria dhe përgjegjësia të fëmijët nëpërmjet tregimit “<i>Pinoku</i>”, me qëllim që të fëmijët të zhvillohet vetëdija për rreziqet nga manipulimi dhe keqpërdorimi, të kuptojnë rëndësinë e besimit dhe sinqeritetit si dhe të mësojnë si të mbrojnë veten e tyre si dhe të tjerët nga trafikimi i fëmijë si dhe nga keqpërdorimet e tjera. Qëllime të veçanta Nxënësit: • E kuptojnë përmbajtjen dhe porosinë e tregimit <i>Pinoku</i>. • I njohin zgjedhjet (vendimet) e mira dhe të këqija të cilat i bën “<i>Pinoku</i>” - personazhi kryesor.

	• Mësojnë se si mosbindja dhe naiviteti mund t'i shpien shumë lehtë në rrezik fëmijët. • E identifikojnë rolin e ndërgjegjes si një zë i brendshëm i cili na paralajmëron kur diçka nuk është në rregull / kur diçka është e rrezikshme. • Bëjnë lidhjen e porosive të tregimit me shembuj bashkëkohorë: rreziqe interneti, profile të rrejshme, trysni nga bashkëmoshatarët, mashtrim dhe tradhti. • Zhvillojnë vetëdijen se gjithmonë mund t'u drejtohen të rriturve të cilëve ju besojnë (arsimtarit, prindit). • Nxiten për mbështetje të ndërsjellë dhe ndjenja e bashkësisë ndërmjet nxënësve.
Rezultatet e pritura	Nxënësit: • E kuptojnë dallimin midis besimit dhe naivitetit. • Zhvillojnë të menduar kritik – të mos besojë menjëherë gjithçka që dëgjojnë. • Njohin manipulimin, mashtrimin, keqpërdorimin nga shembulli i Pinokut. • Zhvillojnë empati (si të futemi në lëkurën e tjetrit) dhe kuptojnë se si ndjenjat mund të ndihmojnë në zgjedhjen e duhur.
Gjatë orës së mësimi	Nxënësit: • Sqarojnë çka nënkupton besimi, si ndërtohet dhe si mund të cenohet. • Japin shembuj konkret nga tregimi se si u mashtrua Pinoku, si reagoi dhe çfarë mori si mësim. • Shprehin reagime emocionale – si ndjehen kur dikush i gënjen, kur bën gabim ose kur u falin ndonjë gabim. • Tregojnë njohje për sjelljen e sigurt –si të mbrohem në kontekst real dhe digjital. • Njohin kur kanë nevojë për mbështetje dhe kur mund ta kërkojnë pa frikë.
Metodologjia / teknika të rekomanduara	• Shqyrtimi i mjeteve audio-vizuale ose lexim i versionit të shkurtër të tregimit me analizë • Diskutim hyrës

	• Punë kreative (krijimi i personazheve) • Lojë me role												
Vlerësimi	<table> <tr> <td>Fusha</td><td>Treguesit/indiktorët</td></tr> <tr> <td>Njohje</td><td>Bënë lidhjen e porositve të tregimit me situata reale.</td></tr> <tr> <td>Ndërgjegjësimi emocional</td><td>I njeh dhe i shpreh ndjenjat e personazheve.</td></tr> <tr> <td>Kreativitet</td><td>Krijon vizatime, ngjyrosë apo luan me rolet e personazheve të tregimit.</td></tr> <tr> <td>Mendim kritik</td><td>Mendon për atë që është e vërtetë, çfarë është mashtrim.</td></tr> <tr> <td>Reflektim</td><td>Shpreh çka ka mësuar dhe si do ta zbatojë atë në jetë.</td></tr> </table>	Fusha	Treguesit/indiktorët	Njohje	Bënë lidhjen e porositve të tregimit me situata reale.	Ndërgjegjësimi emocional	I njeh dhe i shpreh ndjenjat e personazheve.	Kreativitet	Krijon vizatime, ngjyrosë apo luan me rolet e personazheve të tregimit.	Mendim kritik	Mendon për atë që është e vërtetë, çfarë është mashtrim.	Reflektim	Shpreh çka ka mësuar dhe si do ta zbatojë atë në jetë.
Fusha	Treguesit/indiktorët												
Njohje	Bënë lidhjen e porositve të tregimit me situata reale.												
Ndërgjegjësimi emocional	I njeh dhe i shpreh ndjenjat e personazheve.												
Kreativitet	Krijon vizatime, ngjyrosë apo luan me rolet e personazheve të tregimit.												
Mendim kritik	Mendon për atë që është e vërtetë, çfarë është mashtrim.												
Reflektim	Shpreh çka ka mësuar dhe si do ta zbatojë atë në jetë.												
Zbatimi i skenarit	Mësuesi që zhvillon këtë aktivitet vendos në mënyrë të pavarur për përzgjedhjen e aktiviteteve në përputhje me nivelin zhvillimor dhe kontekstin socio-kulturor të nxënësve.												

Aktiviteti: Lojë e sigurt me Pinokun dhe shokët (e udhëhequr nga mësuesi)

Qëllimet:

- Për të kuptuar personazhin e Pinokut dhe temën e mashtrimit.
- Për të përgatitur terrenin për një bisedë rreth mashtrimit dhe manipulimit.
- Fëmijët mësojnë të bëjnë zgjedhje të sigurt, t'u besojnë ndjenjave të tyre dhe të kërkojnë ndihmë nga të rriturit- ndërsa argëtohen duke krijuar dhe duke luajtur me personazhet e tregimit.

Njohja me personazhet! (5 min.)

- Nxënësve u tregohen fotografi të secilit personazh.
- U shpjegohet shkurtimisht se kush është secili personazh dhe çfarë bën në tregim (p.sh.: „Pinoku përpiket të bëjë zgjedhje të mira, por ndonjëherë bën gabime. Bulkthi është ndërgjegjja e tij. Dhelpra dhe Macja ndonjëherë përpiqen ta mashtrojnë.”)

Krijo personazhet e tua (15 minuta)

- Personazhet krijohen nga materiale sipas zgjedhjes së mësuesit duke përdorur plastelinë, vizatime të ofruara të personazheve ose nxënësit vizatojnë vizatime të veta.
- Mësuesi mund ta përdorë këtë kohë për t’ua lexuar ose për t’ua treguar një version të shkurtuar të tregimit, përveç nëse nxënësve u është caktuar si detyrë të njihen me tregimin si detyrë shtëpie, duke përdorur materiale audio-vizuale sipas zgjedhjes së mësuesit.

Ekzekutim në skenë: Çfarë duhet të bëjë Pinoku? (15 min.)

- Fëmijët ftohen të përdorin personazhet e tyre për **skena të shkurtra dhe të thjeshta**.

- Mësuesi:

"Dhelpra dhe Macja takojnë Pinokun, i cili shkon në shkollë, dhe e ftojnë atë të shkojë diku për t'u argëtuar me to."

- "Pinoku pyet veten: *A duhet të shkoj me ta?*"
- "Bulkthi ose ndonjë personazh tjetër mund të thotë: *Bëj kujdes! Pyet një të rritur.*"
- Mësuesi e pyet klasën: "Çfarë do të mund të thoshte Pinoku?" (Fëmijët inkurajohen të përgjigjen ose të interpretojnë: "Jo, më mirë do të pyes një të rritur të besuar!" – **mësuesi e shfrytëzon këtë mundësi për të shpjeguar se çfarë është një i rritur i besuar.**)

- Mësuesi:

"Macja dhe Dhelpra i kërkojnë Pinokut t'u japë paratë në mënyrë që të fitojë "para të lehta", pa asnjë përpjekje apo punë."

- Pinoku pyet veten: "Çfarë duhet të bëj? A duhet t'ua jap paratë e babait tim Xhepetos? Ai punon shumë për t'i fituar ato. Ndoshta mund ta ndihmoj."
- Bulkthi (ose ndonjë personazh tjetër) mund të thotë: „Bëj kujdes! Kjo tingëllon shumë mirë për të qenë e vërtetë. Po sikur të mbetesh me gisht në gojë? Çfarë do t'i thuash Xhepetos?
- Mësuesi pyet: "Çfarë do të thoshte Pinoku?" Inkurajoni fëmijët të përgjigjen ose të interpretojnë: „Jo, do t'i them babait tim se doni të mi merrni paratë. Do t'i tregoj gjithçka Xhepetos dhe do t'i kërkoj këshillën e tij."
- Nëse ndonjë fëmijë thonë se do t'ua jepte paratë mashtruesve, mësuesi e drejton diskutimin drejt:
„Macja dhe Dhelpra ia morën paratë Pinokut dhe nuk ia kthyen më kurrë. Pinoku pyet veten nëse duhet ta gënjejë Xhepeton se i kanë humbur paratë."
- Theksoni rëndësinë e ndërgjegjes (Bulkthi), njohjen e gënjeshtreve dhe ndershmërinë me prindërit. Kërkimi i ndjesës. Xhepetoja fal, por kërkon sinqeritet.

Diskutim dhe ndarje të përvojave (5 minuta)

- "Si ndihej Pinoku kur e mashtruan?"
- "Kush e ndihmoi Pinokun të bëjë zgjedhje të mira?"
- "Kush mund të të ndihmojë kur ndihesh i frikësuar ose i trishtuar?"

Cikli i fundit (3-5 minuta)

- Çdo fëmijë ua tregon personazhin e tij (vizatimin ose figurën) të tjerëve.
- Plotësoni këtë fjali: "Herën tjetër kur të kem nevojë për ndihmë, do ta kërkoj nga___."
- Mësuesi jep një porosi miqësore: "Ashtu si Pinoku, ne mund të kërkojmë ndihmë dhe të përdorim ndërgjegjen tonë të mirë kur nuk jemi të sigurt."

Përfundim dhe zbatueshmëri

Mësuesi i shpie nxënësit te përfundimi:

"Pinoku bëri shumë gabime, por gjithmonë mësonte prej tyre. Kështu që edhe ne mund të jemi të kujdesshëm, por edhe të guximshëm, kur dikush përpiqet të na gënjejë. Sot, rreziqet nuk janë vetëm në rrugë – ato janë edhe online. Kjo është arsyeja pse duhet t'i besojmë ndërgjegjes sonë, prindërve tanë dhe njerëzve që na duan."

Materiale shtesë

Doracak për mësues dhe bashkëpunëtorë profesionalë- Mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi i qenieve njerëzore: çfarë duhet të bëjnë shkollat? [1680a4368b](#)

Materiale edukative dhe informuese (afishe, libra me ilustrime, video) [Publications about Combatting Human Trafficking- Програмска канцеларија на Советот на Европа во Скопје](#)

Doracak për parandalimin dhe ndërhyrjen në dhunë, abuzim dhe neglizhencë në shkolla [priracnik-nastavnici-print.cdr](#) (e disponueshme vetëm në gjuhën maqedonase)

Shenjat paralajmëruese të fëmijët

- Ndryshime të papritura në sjellje (tërheqje, frikë).
- Mungesa të shpeshta ose shmangie të shkollës.
- Kërkesa të shpeshta për mungesa nga shkolla për shkak të dhimbjeve të stomakut, etj.
- Rrëfim i tregimeve që sugjerojnë kontakt me persona të huaj (në jetën reale ose në internet).
- Dhurata, para ose objekte të pashpjegueshme.
- Ankth i dukshëm kur flitet për sigurinë ose besimin.

✦ Këto shenja nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht trafikim të fëmijëve, por ato janë një sinjal se fëmija është në rrezik dhe ka nevojë për vëmendje shtesë.

Kontaktet për ndihmë

- Ministria e Punëve të Brendshme – 192 / 112
- Parashpresa on line <http://redbutton.mvr.gov.mk/>
- Qendra për Punë Sociale
- Shoqata Qytetare "Porta e Hapur/La Strada" SOS 080011111
- Ambasada e Parë e Fëmijëve "Megjashi" +389 70390632

DHELPRA

Biletë Ishull i ahengut



XHEPETO




MACJA



PINOKU



BULKTHI



ZANA



Ky material edukativ u prodhua me mbështetjen e financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.europa.eu

www.coe.int

SQI

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës